

VENDIM
Nr. 879, datë 14.12.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe të ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/1 shtohet emërtimi “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”.

b) Në pikën 1/2 shtohet emërtimi “Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian”.

c) Në shkronjën “a”, të pikës 1/3, emërtimi “Agjencia e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian” shfuqizohet.

ç) Në lidhjen nr.5, që përmendet në pikën 5, shtohen emërtimet e mëposhtme:

“- Auditues i parë në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian – kategoria II-b”;

- Auditues i dytë në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian – kategoria III-a.”.

d) Në lidhjen nr.6, që përmendet në pikën 10, emërtimi “Inspektor në Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian – kategoria II-b” shfuqizohet.

dh) Kudo në vendim, emërtimi “Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizimeve” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizimeve”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë:

a) Për Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, nga momenti i emërimit të nëpunësve/punonjësve në detyrë;

b) Për Agjencinë e Auditimit të Programeve të Asistencës, akredituar nga Bashkimi Evropian, për vitin 2016, nga momenti i emërimit/transferimit të nëpunësve të kësaj agjencie në strukturën dhe organikën e re të këtij institucioni.

c) Për Agjencinë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve, nga momenti i emërimit/transferimit të nëpunësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetës-Kanalizimeve në agjencinë e re.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama